

TERMAT E REFERENCËS PËR POZITËN E PRODUCENTIT/ES NË DOKUFEST

PRODUCENT/E I/E FESTIVALIT

Pas çdo shfaqjeje, ardhjeje të një mysafiri, hapësire, ngjarjeje dhe nate të festivalit qëndrojnë muaj të tërë planifikimi, koordinimi dhe zgjidhjeje të problemeve. Producenti/ja e Festivalit do të udhëheqë planifikimin operacional, koordinimin dhe realizimin e festivalit vjetor të DokuFest-it, duke siguruar që pjesët e shumta të festivalit të funksionojnë së bashku, brenda afateve dhe buxhetit të përcaktuar.

Në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorin Ekzekutiv, Drejtorin Artistik, Administratën dhe Financat, Logjistikën dhe departamentet e festivalit, Producenti/ja do ta lidhë vizionin artistik të festivalit me realitetin praktik të realizimit të tij.

Përgjegjësitë kryesore përfshijnë:

- Zhvillimin dhe mbikëqyrjen e planit kryesor të produksionit të festivalit
- Koordinimin e departamenteve dhe sigurimin që afatet dhe përgjegjësitë e festivalit të ndiqen qartë
- Mbikëqyrjen e hapësirave të festivalit dhe gatishmërisë së tyre operacionale
- Bashkëpunimin e ngushtë me Drejtorin Artistik për të harmonizuar programimin me kërkesat logjistike dhe të produksionit
- Mbikëqyrjen e udhëheqësve të departamenteve dhe mbështetjen e koordinimit efektiv ndërmjet ekipeve
- Menaxhimin e rekrutimit dhe trajnimit të vullnetarëve
- Monitorimin e buxheteve të festivalit dhe bashkëpunimin me Administratën dhe Financat për kontratat dhe shpenzimet
- Menaxhimin e marrëdhënieve dhe marrëveshjeve me furnitorë, hapësira dhe partnerë të jashtëm
- Bashkëpunimin me sponsorë, donatorë dhe partnerë medialë të lidhur me realizimin e festivalit
- Përgatitjen e raporteve operacionale dhe financiare pas përfundimit të festivalit

Po kërkojmë një person shumë të organizuar, të shkathët dhe të adaptueshëm, me aftësi të fuqishme në produksion dhe menaxhim të projekteve, si dhe me kapacitet për të udhëhequr ekipe në ambientin dinamik të një festivali ndërkombëtar.

Përvoja minimale: 5 vjet përvojë në produksionin e ngjarjeve ose festivaleve, mundësisht në sektorin kulturor ose jofitimprurës.